



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 674 Prot.

Durrës, më 12.03.2026

V E N D I M

Nr. 16, Datë 12.03.2026

P Ë R

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË KURSIT "GJUHË SHQIPE PËR TË HUAJT", PRANË
FAKULTETIT TË EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU"
DURRËS"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së, "; vendimit të Senatit Akademik nr. 114, datë 24.10.2025, vendimit të Senatit Akademik nr. 33, datë 05.03.2026, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ofrimit të kursit "Gjuhë Shqipe për të huajt", pranë Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Departamentit të Letërsisë, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Tarifa për këtë kurs do të jetë 400 euro/nivel.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

